

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist për kontrollin dhe certifikimin e pastrimit te hotspoteve dhe depove te A-M	Reparti Ushtarak nr.6604 QMMLFA	Tiranë	Pa afat	Po	Po	02.12.2025	05.12.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Specialist për kontrollin dhe certifikimin e pastrimit te hotspoteve dhe depove te A-M.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Qendra e Menaxhimit të Materialeve dhe Laboratori i Forcave të Armatosura, Reparti Ushtarak Nr.6604.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 27.11.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 05.12.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- | | |
|-------------------|--|
| a. Grada/Titulli: | Specialist për kontrollin dhe certifikimin e pastrimit të hotspoteve dhe depove të A-M |
| b. Arsimi : | I lartë universitar “Bachelor” në shkencat (ing. Mekanike, ing. Mjedis, ing. Kimi industriale), I lartë ushtarak, specialiteti Xhenio/Armatim- municion. |
| c. Kualifikimi: | Tw ketw kualifikime në EOD brenda ose jashtë vendit. |
| d. Trajnimi: | Trajnime në fushën e kërkuar. |

e. Eksperienca në Punë: f. g. Gjuha e huaj: h. Kërkesa të tjera specifike: i. Niveli i certifikatës së sigurisë:	Të ketë përvojë pune 3 vjet në strukturat e pastrimit të hotspotëve civile ose ushtarake. Anglisht. Të ketë njohuri të mira në fushën e kërkuar dhe të përdorë programet bazë të kompjuterit (word, excel, powerpoint, database etj). sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulorës për sigurinë e personelit”.
Përshkrimi i punës: Specialist për kontrollin, certifikimin dhe pastrimin e hotspotëve të A-M, është përgjegjës për këshillimin e përgjegjësit të sektorit planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve të ERË/UXO në Shqipëri . Detyrat kryesore: • Këshillon përgjegjësin e sektorit për planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve të ETW/UXO në Shqipëri. • Planifikio dhe bashkërendon operacionet e pastrimit UXO/ERW në zonat e ndotura të pikave të nxehta në Shqipëri sipas planit kombëtar dhe nën drejtimin e përgjegjësit të sektorit. • Planifikon dhe drejton aktivitetet e ekipit të menaxhimit të cilësisë në ekzekutimin e detyrave të tyre. • Asiston në përgatitjen e dosjeve të detyrave për të gjitha detyrat e sondazhit dhe pastrimit të UXO/ERW në Shqipëri. • Siguron ndërlidhjen me agjencitë dhe OJQ e tjera në lidhje me informacionin e pastrimit të UXO/ERW dhe përditësimin e informacionit të organizatave partnere në çështjet IMSMA dhe GIS. • Përgjigjet për ndërlidhjen në lidhje me MEDEVAC, dorësimin e municioneve të gjetura nga ekipet e njësive EOD të FA për rrënim siç kërkohet.	
13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: ▪ përzgjedhjen paraprake; ▪ vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; ▪ intervistën e strukturuar me gojë. Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.	

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.